

THIRRJE PUBLIKE

për studentët e nivelit bachelor dhe master në Kosovë

Konsorciumi i organizatave OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”, “Terre des hommes” dhe Fondacioni “HEKS/EPER”, hap thirrjen për hulumtime analitike apo position papers për studentët e nivelit bachelor dhe master në Kosovë.

Kjo thirje ka për qëllim draftimin e pesë hulumtimeve/position papers të cilat synojnë analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale cila lidhet ngushtë me çështjet e komuniteteve të marginalizuara e të cilat ndikojnë negativisht në përfshirjen e tyre në shoqërinë kosovare. Këto hulumtime (position papers) duhet të adresojnë të gjitha aspektet e çështjeve në fjalë duke qenë të kuptueshme për publikun dhe duke përfshirë analizën e dokumenteve ekzistuese (ligjet në fuqi, skemat sociale ekzistuese, hulumtime dhe raporte), intervista dhe pyetësorë me grupet e marginalizuara si dhe rekomandimet. Inkurajohen studentët e fushave të ekonomisë, sociologjisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, dhe politikave publike të aplikojnë duke dërguar ofertat e tyre financiare.

Studentët mund të zgjedhin njëren nga pesë temat e listuara më poshtë:

1. “Ndikimi i skemës sociale në planifikimin familjar tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian”

Shumica e anëtarëve të tri komuniteteve jetojnë në margjina të shoqërisë, me nivel të lartë të papunësisë dhe arritje të ulët arsimore në krahasim me komunitetin shumicë. Shpeshherë jetojnë në vendbanime të cilat në disa raste janë joformale, me infrastrukturë të dobët, dhe në shtëpi që janë në kushte të mjerrueshme. Për më tepër, anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, dhe gratë në veçanti, përballen me barriera që çojnë në përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës. Në të njëjtën kohë, shumë pjesëtarë të tri komuniteteve marrin ndihmë sociale dhe planifikimi familjar është ngusht i lidhur me kriteret e skemës sociale. Ministria e financave, punës, dhe transfereve ofron ndihmë sociale për të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit

- o 60 EURO është shuma minimale (familja me 1 anëtare)
- o 180 EURO është shuma maksimale (familja me 15 anëtare)

Përveç ndihmës bazë, familja që është shfrytëzuese e ndihmës sociale për çdo fëmijë të moshës 0-18 vjeç merr edhe nga 5 EURO në muaj si formë e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit të tyre. Rreth 2,992 familje me 14, 051 anëtarë të familjes nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo skemë gjatë vitit 2021.

Supported by:

Si ndikon skema sociale ne punesimin e komuniteteve? Sa nderlidhet skema sociale me planifikimet familjare? A ndermerr shteti masa te mjaftueshme per me i largu familjet e varfera nga skema sociale? Cilat jane masat qe jane ndermarre ndër vite nga qeveritë?”, “Praktika nga vendet tjera? Cfare duhet te planifikohet ne 2023?

2. “Punësimi dhe kycja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në tregun e punës në sektorin privat”

Me këtë analizë synohet te hulumtohet situata aktuale e te punesuarëve ne sektorin privat. Të vetëdijshëm që gjendja e komuniteteve Egjiptian, Rom, dhe Ashkali në Republikën e Kosovës, në sektorë dhe sfera tjera të shoqërisë nuk është e mirë, fokusi i kësaj analize është të paraqitet gjendja në aspektin e punësimit dhe ofrimit te mundesive të punësimit në sektore te tjere duke u bazuar ne kuadrot profesionale.

Përkundër këtij progresi, kombinimi i shumë faktorëve si problemet strukturore të tregut të punës, format e ndryshme të diskriminimit, niveli i ulët i arsimit dhe mungesa e shkathtësive vazhdojnë të sfidojnë mundësitë për punë të denjë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Për pjesëtarët e rinjë të këtyre komuniteteve, këto sfida amplifikohen nga mosha e tyre e re, duke rezultuar me marginalizim serioz dhe përjashtim nga tregu i punës.

Ne rekomandimet e prezantuara duhet te mirren parasysh: “Si mund të ndikojnë masat shteteore ne rritjen e punesimit ne sektorin privat?”, “Cilat janë masat që janë ndërmarrë ndër vite nga qeveritë?”, “Praktika nga vendet tjera? “Qëndrueshmëria në Kosovë dhe mundesit e punesimit?” “Cilat janë masat/aktivitet që mund të ndërmirren gjate 2023?”

3. “Mos/Besimi i qytetareve rom, ashkali dhe egjiptian per raportimin e rasteve te diskriminimit ndaj administratës publike dhe organeve shtetërore”

Policia dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit luajnë një rol të rëndësishëm në riprodhimin antigjipsizmit, si një nga institucionet shtetërore që jane rregullisht në kontakt qytetarët. Në hulumtimin nacional mbi antigjipsimin ne Kosove, njerëzve iu kërkua të komentojnë për krimin dhe drejtësinë në lidhje me shënjestrimin e policisë ndaj romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, për ashpërsinë e dënimeve gjyqësore dhe trajtimin e policisë. Përgjigjet ishin se 35% e të anketuarve jo-romë-ashkali-egjiptianë priren të pajtohen ose pajtohen plotësisht se “Në veprimet e saj, policia më shpesh synon komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, një pikëpamje e përbashkët nga 56% e të anketuarve romë, ashkali dhe egjiptianë. Kur u pyetën nëse “Kur nën arrestimin e policisë, romët, ashkalitë dhe egjiptianët trajtohen më keq se shqiptarët”, 53% e të anketuarve romë, ashkali dhe egjiptianë priren të pajtohen ose plotësisht pajtohen me këtë deklaratë, për dallim nga 64% e të anketuarve jo-romë, ashkali dhe egjiptianë që nuk pajtohen ose priren të mos pajtohen. Ne baze te hulumtimi nacional mbi antigjipsimin ne Kosove pjesetaret e komuniteteve hezitojne ti raportojne rastet e diskriminimit duke pretenduar se per shkak te paragjykimeve nuk do te mirren masa apo te trajtohet rasti nga organet kompetente.

4. “Analizimi i vendbanimeve jo formale dhe menyrat e formalizimit te tyre”

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptianë janë ndër grupet më të marginalizuara të popullsisë dhe jetojnë në kushte te veshtira ekonomike dhe vendbanime te cilat nuk i plotesojne kriteret minimale te jeteses.

Supported by:

Shumë prej tyre jetojnë në njësi banimi nën standarde minimale të jetesës, qendra kolektive ose vendbanime joformale. Prandaj, duke u bazuar në këto fakte, organizata “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians”, synon regjenerimin e vendbanimeve jo formale, duke i bashkuar parcelat dhe transformuar ato në lagje urbane me standarde banimi me ndërtime të mesme dhe të larta, me etazhitet sipas kriterëve të caktuara me Hartë Zonale, ku do të sistemoheshin familjet aktuale do të siguroheshin hapësirat e gjelbërta dhe rekreative dhe kënd për lojra të fëmijëve, të gjitha këto në harmoni me planet urbane e zhvillimore komunale dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.

5. Gratë rome, ashklike dhe egjiptiane në politikë, përtej kuotave

Barazia gjinore nuk është vetëm e drejtë themelore njerëzore dhe cak zhvillimor kudo. Fuqizimi grave dhe një mori mekanizmesh të tjerë për arritjen e barazisë gjinore, janë të domosdoshëm për zhvillim përfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm, dhe rrjedhimisht me rëndësi themelore për mirëqenien socio-ekonomike të shoqërisë. Pjesëmarrja politike e grave është kyçe për këto qëllime, dhe partitë politike janë ndër institucionet më të rëndësishme për promovimin dhe zhvillimin e një pjesëmarrjeje të tillë. Shumica e partive politike nga radhët e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom të intervistuar nuk kanë paraparë prioritete dhe masa për ngritjen e pjesëmarrjes së grave në programet e tyre partiake dhe vetëm një parashih me statut pjesëmarrjen e obliguar prej 30%.

Megjithatë, gjatë këtyre dy dekadave të zgjedhjeve të lira e demokratike, sa kanë arritur gratë e komuniteteve egjiptian, rom dhe ashkali të gëzojnë këtë të drejtë?

Inkurajoheni të krijoni temën tuaj origjinale dhe argumentet tuaja duke u bazuar në temat e listuara.

Udhëzimet për aplikim

Të gjithë të interesuarit, duhet të aplikojnë në bazë të udhëzimeve në vijim, pas pranimit të aplikacionit do të përzgjidhen aplikimet në bazë të shkrimit dhe ofertës financiare. Të përzgjedhurit, do të kenë afat kohor dy muaj për të përfunduar dokumentin e detajuar pas përzgjedhjes nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

- Autorët e shkrimeve duhet të jenë studentë të nivelit bachelor ose master;
- Aplikimet / Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të pabotuara. Shkrimet e kopijuara do të refuzohen;
- Shkrimet duhet të shkruhen nga një apo dy autorë. Shkrimet nga më shumë se dy bashkë-autorë nuk do të pranohen;
- Shkrimet duhet të jenë deri në 500 fjalë. Shkrimet më të gjata do të diskualifikohen automatikisht;
- Burimet e të dhënave duhet të citohen brenda tekstit/me fusnotë. Nuk ka nevojë për listë referencash;
- Shkrimet duhet të dërgohen në format Word MS, në emailin nj.uka@vora.org. Po ashtu, duhet të bashkangjiteni kopjen e skanuar të kartelës studentore apo ndonjë dëshmi tjetër që tregon se jeni student/e në ndonjërin prej institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë në kohën e dorëzimit të shkrimeve.
- Në titullin e emailit (Subject) shkruani “Temen - Emri dhe Mbiemri”.
- Afati i fundit për dorëzim të shkrimeve është më 9 dhjetor 2022 në mesnatë.
- Shkrimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren parasysh.

Supported by:

Formati i shkrimeve

- Hyrje

Paragrafi hyrës duhet të përfshijë tezën apo qëllimin e shkrimit, rreth temës kryesore të tij.

- Përmbajtja

Vendosni të gjitha të dhënat dhe faktet te cilat mbështesin argumentet tuaja. Organizoni idetë në sa më shumë paragrafë të nevojshëm që mbështesin tezën apo qëllimin e shkrimit tuaj. Nëse keni tri argumente, shkruani ato në tre paragrafë duke i radhitur sipas rëndësisë dhe potencialit për t'i mbështetur ato.

- Përfundimi

Mos vendosni informacione apo të dhëna të reja në këtë paragraf. Vetëm përmbledhjeni mirë shkrimin duke ripërmendur argumentet kryesore të tij dhe duke sinjalizuar fundin e tij apo duke bërë një "thirrje për veprim dhe rekomandime baze që duhet të nderimen në të ardhmen" nëse shkrimi juaj do të shkruhet në atë mënyrë që të bind lexuesit të veprojnë kundrejt diçkaje.

Oferta financiare për dite pune duhet të përmbajë pikat në vijim/ pagesa është konkurruese

Pershkrimi		Afatet kohore
T1.	Metodologjinë	Dite pune 1
T2.	Hulumtimi në tavolinë/Desk Resarch	Dite pune 2
T3.	Përgatitja e pyetësorit	Dite pune 1
T4.	Organizimi I focus grupeve	Dite pune 1
T5.	Analiza e rezultateve	Dite pune 1
T6.	Raporti Përfundimtar	Dite pune 3

Çdo anëtar/e i/e panelit do të vlerësojë përmbajtjen e përgjithshme me pikë dhe tri shkrimet me pikët më të larta do vlerësohen me çmime. Vlerësimi bëhet nga konzorciumi

Vetëm fituesit do të lajmërohen.

Supported by: